



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assemble

Legjislatura V

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 03/2015

Prishtinë, më 16.01.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa- kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca - anëtarë.

Munguan: Pal Lekaj, Fatmir Limaj dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrësi i ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Nazmi Zenelaj, Ardit Gashi, Dukagjin Shala, Halit Hoxhaj - MZHE; Lumnije Murati - ZPRK; Burim Ejupi dhe Dardan Abazi – INDEP; Qëndresa Mrasori- KDI; Lejla Selimi - OSBE; Visar Rushiti dhe Berat Thaçi - GAP

Pjesëmarrës nga mediat: Valmira Saraçi- KTV; Pranvera Musa- Kosova Press; Kosovë Gjoci – klan Kosova; Faton Salihu-RTK; Bleta Gashi-Rrokum TV; Amir Qamili- BIRN; Sylejman Bakaj- Kosova Sot; dhe Liridon Llapashtica, gazeta "Zëri".

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Projektligji nr. 05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Projektligji nr. 05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se duke u nisur nga një shkresë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe nga një shkresë që e morëm nga drejtori i Trepçës, ne e analizuam këtë situatë dhe nxorëm një rekomandim, të cilën e dorëzuam në Kryesi të Kuvendit dhe në Qeveri, ndërkohë në Qeveri dhe ministri kanë qenë duke u përgatitur masat përkatëse lidhur me këtë projektligj. Pastaj, ia dha fjalën ministrit që të prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), paraqiti në pika të shkurtra Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 031/087 për ndërmarrjet publike. Ai tha se është e nevojshme ndoshta një informatë e përmblodhur se cila ka qenë arsyeja që na është dashur që të veprojmë me shpejtësi. Siç e dini, në vitin 2011, në Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve shoqërore, është paraparë që të njëjtat për një afat prej nëntë, maksimalisht, pesëmbëdhjetë muajve, duhet ta dërgojnë planin e ristrukturimit dhe për një procedim të shpejtë të kësaj çështjeje, për arsye të natyrës së saj urgjente nëse një gjë e tillë nuk bëhet, pra nuk iu përmbahen këtyre afateve, atëherë pasojnë disa sekuenca ligjore në bazë të ligjeve tjera që rregullojnë fushën, për shkak të një vendimi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në të cilin thuhet që plani duhet të dorëzohet deri më 2 shkurt. Ndryshimi midis atij projektligji nga legjislatura e kaluar dhe ky që do ta keni ju është, sepse është paraparë me një nen të veçantë, që në propozim të Qeverisë, një ndërmarrje shoqërore apo ndonjë njësi organizative e saj, mund të transformohet në një ndërmarrje publike. Në ndërkohë ne duke e ditur se jemi në një presion kohor, edhe pse vendimi është i formës së prerë dhe koha ka filluar të skadojë që nga dita e hënë, ne sot jemi në datën 16 janar, duke dashur që t'i respektojnë të gjitha procedurat kuvendare dhe afatet ligjore, është dashur që Qeveria të marrë vendim, në bazë të ligjit, që ndonjërin nga këto ndërmarrje shoqërore apo ndonjë njësi organizative të saj, ta transferojë në ndërmarrje publike. Ne kemi parë të arsyeshme për ta shpejtuar procesin dhe duke e ditur rëndësinë e Trepçës, ta fusim dhe një nen të veçantë me të cilin specifikohet kompleksi "Trepça". Pra, kemi dashur edhe të jemi në një anë promotor, duke e ditur rëndësinë e Trepçës, të idesë për ta transformuar në ndërmarrje publike, por edhe në anën tjetër për të qenë pararojë e ndonjë procesi të mundshëm ku ne nuk mund të ndërhyjmë, por ku i kemi në duar instrumentet ligjore për ta parandaluar atë.

Kryetari, mendoj se është plotësisht e qartë se çështja e Trepçës si një ndërmarrje aktualisht shoqërore apo si një ndërmarrje me rëndësi strategjike dhe me një rëndësi shumë të madhe shoqërore, ekonomike është menaxhuar jo siç duhet nga AKP-ja dhe nga Dhoma e Posaçme, sepse në mënyrën në të cilën është menaxhuar ajo, ka ardhur gjithmonë në vështirësi dhe është penguar në zhvillim dhe në vend që të hyjë në ristrukturim dhe të kryhen shumë punë, kjo ka ngecur, dhe ne për shkak të këtyre ngecjeve kemi ardhur deri në një situatë ku i kanoset falimentimi. Ne jemi këtu si Kuvend, si Qeveri dhe të gjithë duhet t'i pengojmë këto pasoja që Trepçën ta nxjerrim nga një menaxhim joadekuat nga një përkujdesje joadekuate, në një pistë të menaxhimit të duhur nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit. Ky ligj është i mirë dhe natyrisht që ndërkohë, deri sa të aprovohet, edhe pse duhet të aprovohet shpejt, duhet të shihen edhe disa çështje, në bashkëpunim me Qeverinë dhe Ministrinë dhe me ekspertë të caktuar, që mund të bëjnë me çështjen e obligimeve. Natyrisht që kreditorët të cilët janë realë, nuk kanë pse frikohen, sepse shteti i Kosovës në mënyrën më të mirë i ka rregulluar si asnjë vend tjetër në Ballkan obligimet ndaj kreditorëve edhe në AKP, por edhe në rastin e Trepçës. Por, sigurisht, ata të cilët nuk janë realë dhe janë fiktivë, krijojnë një atmosferë politike se gjoja që Trepça ka shumë obligime dhe shumë kredi, ata që natyrisht nuk do të merren në konsideratë në procedurat e mëtejme. Pra, kjo është zgjedhur me nenin 5. Një çështje tjetër që ka të bëjë me këtë, duhet ta

shohim relacionin e këtij ligji me Ligjin për ristrukturim të ndërmarrjeve të posaçme, aty ka qenë edhe moratorium me kërkesa të kreditorëve, por për të gjitha këto do të kemi kohë për t'i parë deri në mbledhjen tjetër. Edhe një çështje që duhet ta shohim, meqenëse jemi te çështja tek bordet e ndërmarrjeve publike, në ligje është theksuar shumë mirë përgjegjësia e menaxhmentit, por jo edhe e bordeve për menaxhim të ndërmarrjeve publike.

Visar Ymeri, tha se është diskutuar edhe më herët, pra që kemi të bëjmë me njërën nga asetet apo pasuritë më të mëdha që kemi në vend, si në aspektin strategjik, ashtu edhe në atë ekonomik – social, por dorën në zemër edhe emocional. Në këtë drejtim, unë kam një kritikë e cila është pak ku unë po e kuptoj objektivitetin e ngutjes, por prapë kjo ngutja neve po na shtyn drejt gabimeve tjera, pra neve po e zgjedhim një problem të atypëratyshëm, por në anën tjetër po rrezikojmë probleme të tjera, për shkak të mungesës së kohës së mjaftueshme për ta trajtuar çështjen, ashtu siç kjo kërkon. Të mos harrojmë se ky Kuvend e ka hartuar Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve, dhe atëherë, ne si VV kemi qenë jashtëzakonisht kundër dhe një pjesë e LDK-së, po ashtu, kanë qenë kundër. Ne edhe atëherë i kemi ngritur këto çështje për të cilat sot po flasim dhe tani mua më kujtohet që ka pasur edhe kërkesa të deputetëve që të përjashtohet shprehimisht Trepça nga ky Ligj. Mënyra sesi është përpiluar plotësimi- ndryshimi i projektligjit dhe disa gjëra të cilat për mua të paktën janë të paqarta, siç është çështja që ka të bëjë apo i referohet nenit 3, pika 11.5, që propozohet apo referohet për t'u shtuar në Ligjin për ndërmarrjet publike. Pra, unë mendoj se nuk duhet të jemi të pakujdesshëm karshi rrethanave në të cilat ndodhet Trepça, pra që të gjithë ne e dimë, pra shumë thonë që ndarja e Mitrovicës na ndau Trepçën, por ka shumë që thonë që edhe ndarja e Trepçës na ndau Mitrovicën. Pra, në këtë drejtim, ne i dimë edhe pretendimet e Serbisë karshi Trepçës, edhe pretendimet e strukturave paralele që veprojnë atje, por edhe veprimet e vetë menaxhmentit të një pjese të Trepçës që është në veri. Në këtë drejtim, konsideroj që ky nen mund të ketë edhe implikime të dialogut të mëtutjeshëm me Serbinë, në veçanti, nëse do të diskutohet edhe Trepça. Kështu që në këtë drejtim konsideroj që edhe propozimi i VV-së sigurisht që do të vendosë edhe në seancë, që ky ligj të amendamentohet në në parim. Ne jemi që Trepça të jetë ndërmarrje publike, por në parim duhet t'i marrim të gjithë mekanizmat, në mënyrë që si Kuvendi, bashkë me ekzekutivin, të ketë fjalën përfundimtare për përfundimin e vendimeve të projekteve, përndryshe po që se i lihet vetëm ekzekutivit, natyrisht që këtu mosbesimi është shumë i madh dhe mundësia për të vepruar me Trepçën, po aq keq sa do të ishte edhe likuidimi i saj.

Fatmir Rexhepi, tha se nuk ka dilemë që pesha e ndryshimit të këtij problemi është shumë e madhe. Ne kemi dhënë vendimin tonë dhe vendimin ynë unanim që është dhënë, është që të ecim përpara që mos të vonohemi. Tash mendimi me të gjithë deputetët është që në ministrinë përkatëse ta shohim se çka është përcaktuar dhe e asaj se çka duhet të përfundojë Kuvendi, të bëhet ai ndryshim i cili juridikisht duhet të jetë i plotfuqishëm, pra do të ketë mundësi që të implementohet. Trepça e ka një peshë të veçantë në ekonominë e vendit edhe për Qeverinë, por të shohim edhe bazën juridike për ndryshimin edhe për çështjet tjera, por jo në mënyrë urgjente, sepse në këtë mënyrë urgjente, ne mund të bëjmë edhe gabime. Unë mendoj që vonesa e cila është shkaktuar nga qeverisja e kaluar, absolutisht është përgjegjësi e asaj Qeverie dhe e askujt tjetër. Ndërsa, me këtë projektligj, është një rast i mirë që të shfrytëzohet dhe të bëhen edhe ndryshime të tjera, në kuadër të kësaj iniciative, bie fjala te kërkesat e kuvendeve komunale ku është marrë prona nga ndërmarrjet shoqërore, ku është marrë toka në qendër të qytetit dhe kanë mbetur komunat pa asnjë mundësi për të zhvilluar partneritetin publiko-privat. Prandaj, thirrja ime është që të kërkohet përkrahje e plotë së bashku ta bëjmë të komplementar dhe t'i japim një shans të mirë që mos të kemi probleme në të ardhmen.

Blerim Grainca, çështja për të cilën po diskutojmë, përveç që është urgjente në afatin kohor, mendoj se Trepça nuk është vetëm një ndërmarrje e thjeshtë shoqërore që shndërrohet në një ndërmarrje publike, por është një aset me karakter nacional. Tha se është për këtë propozim për

ndryshim dhe plotësim të ligjit që është propozuar nga Qeveria, të kalojë në parlament dhe të ketë mbështetjen tonë si grup, me arsyetimin dhe dëshirën që të mos mbesim vetëm me nivelin e ligjeve, por të punohet më shumë edhe me implementimin praktik dhe të mbulojë edhe çështjet të cilat merren edhe me realitetin, sepse siç e dimë, Trepça sot menaxhohet nga dy menaxhmente dhe do të duhet që ky ligj të përcaktojë qartë që përfshin të dy menxhamentet në kompanitë publike në Trepçë. Edhe çështja e borxheve është thënë se ka një arbitrazh, por të specifikohet se cilat gjykata dhe cilat borde i mbulojnë, sepse kemi 1300 kreditorë, që shumica prej tyre janë kërkesa fiktive dhe jo të arsyetuara apo të krijuara gjatë viteve '90.

Sala Berisha- Shala, kjo që ka ardhur tani, nuk është e përkryer, por mendoj që për kohën dhe momentin është më e mira dhe jam gjithmonë kundër që mos ta fus të mirën me të përkryerën, sepse nuk arrijmë askund. Më në fund ka ardhur fundi i kësaj apo të fatit të Trepçës, por dhe i ka ardhur fundi i një ngulfatje ekonomike, ku konsideroj se pasuritë nëntokësore gjigante, siç është Trepça në fjalë, është një shtyllë e fortë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Mendoj se ne mund të debatojmë edhe më gjatë edhe më tutje për Trepçën, por besoj që jemi sot në një pozitë apo në një akt të tillë ku mund të them që ne duhet bashkërisht ta miratojmë dhe ta procedojmë sipas rregullave të Rregullores së Kuvendit për seancë, e cila do të mbahet të hënën dhe që është shumë shkurt dhe besojë që do të kemi mundësi të bëjmë ndryshim lidhur me ato ndryshime të mundshme dhe ta ulim sa më shumë rrezikun të cilin e shohim që është paraqitur këtu në mes dy leximeve. Dhe, të gjitha gjërat të cilat kam pasur t'i them, i kam thënë jo vetëm në seancën e kaluar, por edhe në një libër në të cilën jam vetë bashkautore e ekspertëve dhe njerëzve kompetentë, të cilët kanë punuar shumë në lidhje me Trepçën – pasuritë nëntokësore.

Raif Qela, jemi para një akti mjaft të rëndësishëm, deri para disa javësh nuk është ditur afati i rrezikut për ta futur Trepçën në likuidim që është kaq i afërt. Nëse ne nuk i ndërmarrim hapat e nevojshëm dhe nëse nuk tregohemi të shpejtë, ashtu siç e kërkon edhe nevoja ta procedojmë këtë ligj dhe ta procedojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse kemi rrezik që ta humbim Trepçën apo pjesë të saj, varësisht prej punës sonë që e bëjmë këto ditë, që do të varet fati i Trepçës. Hap i nevojshëm është ky projektligj, të cilin sot e kemi dhe të cilin duhet ta procedojmë në lexim të parë të hënën.

Besim Beqaj, tema e Trepçës është temë e cila është diskutuar gjatë dhe me ndjeshmëri të veçantë, si nga karakteri i saj si Trepçë, por edhe nga karakteri se si njerëzit apo populli ynë na lidh me Trepçën. Mendoj se nuk është mirë që të nxitohemi të themi që është kohë e humbur apo jo se normalisht është bërë një veprim i cili nuk e ka ndihmuar zhvillimin e Trepçës, aq sa është dashur, por asetet e saj i ka ruajtur deri më tani. Ne po flasim për ndryshim të statusit të këtij kompleksi, nga një ndërmarrje shoqërore në administrim, në ndërmarrje publike dhe mund të them se nuk është ndërmarrje sikurse të tjerat. Trepça si tërësi, si një ndërmarrje unike, si një ndërmarrje e menaxhimit unik, e cila duhet të dalë si logjikë e këtij ligji, sepse qëllimi ynë është të kemi një ndërmarrje unike publike si Trepça, e cila do t'i ruante asetet e saja dhe aktivitetin e vet ekonomik dhe të rigjenerojë aktivitet ekonomik dhe vende pune. Ky është synimi të cilin ne e kemi para vete në këtë ligj. Normalisht, ne e kemi edhe një dokument paraprak, i cili ka kaluar në Kuvend dhe ai është Strategjia Minerare dhe është dokument për të cilin është debatuar disa herë në Kuvend dhe nuk ka kaluar me shpejtësi, por është kthyer 2-3 herë në Kuvend. Pra, Strategjia Minerare definon qartë cilat janë aktivitetet e saj, cilat janë aktivitetet e rëndësishme të saj, të cilat Trepça në të ardhmen duhet t'i ketë. Pra, unë konsideroj që kur flasim për amendamentim, posaçërisht nenin 3, pika 11.5, kur flasim për pozicionimin e saj në kuptimin e kompetencave ndërkombëtare, ne duhet të bëjmë të qartë se cilat janë përgjegjësitë e ndërmarrjes së re të ndërmarrjes publike, të cilat do të duhet të ishin si tërësi, por gjithmonë duke pasur parasysh që obligimet të mbeten tek Trepça. Nuk jam për, që amendamenti të shkojë si i tillë, për shkak se konsideroj që ky amendament mund të krijojë përgjegjësi, i cili mund ta vë shtetin në obligime goxha të mëdha para kreditorit, duhet të kemi parasysh se duhet ta ndajmë një çështje

kreditore e cila është themeluar me ligjin paraprak dhe ata të merren me çështjet e njëjta, dhe mbi këtë bazë, mendoj se duhet të fillojë një nismë goxha e mirë, të cilën e ka filluar Ministria. Unë e kuptoj shumë mirë që është gjendje urgjente dhe nuk është hera e parë që kemi urgjenca për Trepçën.

Sasha Milosavljeviq, ju njoftoj se Lista Serbe do të votojë kundër këtij projektligji.

Blerand Stavileci, të gjitha përpjekjet tona duhet të orientohen nga sot për të edhe për seancën e së hënës dhe mendoj që të vetmin instrument që kemi si dokument ligjor, është ky, sepse nuk ka të tjerë, edhe po t'i kërkonim, është ky dhe unë mendoj se kemi krijuar një bazë për ta trajtuar, definuar dhe për t'i evituar pasojat dhe pastaj brenda kësaj baze të krijuar, mendoj që është rregulluar me procedura. Unë personalisht, por edhe personeli i Ministrisë, së bashku me gjithë ekspertët, jemi në dispozicionin tuaj, në mënyrë që t'i bëjmë gjërat më të mira brenda këtij instrumenti që e kemi përfundimisht, e si ligj, si plotësim- ndryshim aktual për ndërmarrjet publike, e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryetari, tha se debati ishte frytdhënës dhe të gjithë e kemi të qartë se ne po nxjerrim një ligj që është unik për Trepçën dhe të gjithë jemi në dijeni që ky ligj i mbron më së miri interesat e gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh nacionalitetin, ky është qëllimi ynë. Ne, në këtë ligj, e as Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk kanë të bëjnë me ndarjen në mes të nacionaliteteve, por kanë përgjegjësi që brenda kufijve të Kosovës dhe territorit të Kosovës, në bazë të Planit gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe Kushtetutës së Kosovës.

Pas debatit, Komisioni, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr .05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji nr. 05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Komisioni vendosi që t'i propozojë Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, për miratim këtë

PROPOZIM-VENDIM

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike, të bëhet me procedurë të përsheptuar-shmangie nga afatet dhe procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa